



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	09.08.2023
Për:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Kopje:	Arkivit
Nga:	Komisioni Vlerësues
Lënda:	Raporti i vlerësimit për shpalljen e fituesit të Njoftimit Publik me numër 01-me numër 01-353/01-10071

I nderuar Kryetar,

**Komisioni Vlerësues** (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01Nr.011/01-8158 të datës 30.03.2022, duke u bazuar në nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujatshme të Komunës, nenit 12 të Rregullore (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujatshme të Komunës, me qëllim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01 Nr.011/01-3512 të datës 07.02.2022 dhe të vendimit numër 01Nr.011/01-8186 të datës 30.03.2022, të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, si dhe Njoftimit Publik me numër 01-353/01-10071 të datës 18.05.2023. Pas vlerësimit të ofertave në njoftimin publik, komisioni ka përzgjedhur ofertën me çmimin me të lartë të ofruar në ankand publik.

I përzgjedhur është: Risuf Haxhija, me adresë: Rr. "Ismail Qemali" Gjakovë.

Pas përfundimit të afatit të ankesave, si dhe procedurave administrative Komisioni nxjerr këtë:

### R e k o m a n d i m

Rekomandohet Kryetari i Komunës të nënshkruan kontratën me fituesin, me të cilën kontratë përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.



Kosovar Alija

Mustafa Domi

Adelina Shehu – Kola

Idriz Daci

Teuta Pallaska – Milla